

## Njoftim

Sot, më datë **24.05.2023**, ora **14:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Emona Muçi (Relatore);**
- 2. Blerona Hasa (Anëtare);**
- 3. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 4. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 5. Manjola Xhaxho (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.20 Regj.Themeltar, Datë 15.05.2023 Regjistrimi, me:

**Paditës:** Armando Subashi.

**Të paditur:** Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror;

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor, KQZ-së.

**Objekti:** Shfuqizimin e Vendimit (pa numër), datë 08.05.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor, KQZ-së.

**Baza ligjore:** Neni 152, 153 i ligjit nr.10019 dt.29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr.9 dt. 09.03.2021 dhe vendimi nr.9 dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, për shkak të mosparaqitjes së pajustificuar të paditësit në seancë gjyqësore, me Vendimin Nr.21, datë 24.05.2023,

### VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit të çështjes nr.20, datë 15.05.2023.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.  
U shpall në Tiranë më datë 24.05.2023.

**Tiranë, më 24.05.2023**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**